

Biografi – Qëndrim Hoxha

Qëndrim Hoxha është një lider vizionar dhe ekspert i mirënjohur në fushën e menaxhimit, udhëheqjes dhe zhvillimit rinor në Kosovë dhe më gjerë. Aktualisht kandidat për doktoratë në Universitetin “St. Kliment Ohridski” në Shkup, ai kombinon njohuritë akademike me përvojën shumëdimensionale në sektorin civil, arsimor dhe ndërkombëtar. Me një rrugëtim që përfshin gati dy dekada angazhim aktiv, Hoxha është CEO i degës së Kosovës në Leadership Development Association Europe si dhe bashkëthemelues i degëve të LDA-së në Maqedoni të Veriut, Mal të dhe Luginë të Preshevë. Ai gjithashtu është dhe figurë kyçe në konferencat ndërkombëtare DREAMin dhe LEAP që po mbahen në ballkanin perëndimor.

Ai ka kontribuar drejtpërdrejt në hartimin e disa strategjive zhvillimore komunale, ka qenë pjesë e Këshillit për bashkëpunim mes Qeverisë dhe Shoqërisë Civile dhe ka drejtuar me sukses projekte të shumta në nivel vendor e ndërkombëtar. Qëndrimi është i njohur për aftësitë e jashtëzakonshme organizative, përkushtimin ndaj rritjes së kapaciteteve të të rinjve dhe promovimit të vlerave demokratike.

I pajisur me mbi 30 certifikime kombëtare e ndërkombëtare dhe i nderuar me dhjetëra mirënjohje, ai vazhdon të frymëzojë brezat e rinj përmes lidërshiptit të tij të natyrshëm dhe pasionit për ndryshim pozitiv në shoqëri.